



PROTOKOLLI JESHIL I MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE DISTANCIMIT SOCIAL

- 1- Subjekti fillimisht verifikon objektin e veprimtarisë së tij duke vetëpërcaktuar nivelin e riskut sipas kodeve të veprimtarisë. Në rast të aktiviteteve me natyrë të përzier ku një subjekt ushtron disa aktivitete, vetëpërcaktimi do të kryhet sipas adresave sekondare dhe llojit të çdo aktiviteti.
- 2- Person i caktuar nga administratori/personi fizik kryen çdo ditë vetëvlerësimin personal dhe të personave të punësuar nëse kanë simptoma të COVID-19 sipas checklistës së miratuar. Në rast të simptomave nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe duhet të raportohet menjëherë si rast në numrin 127.
- 3- Subjekti lejohet të veprojë vetëm në orarin e caktuar.
- 4- Personeli i punësuar/Administratori/Personi Fizik Tregtar duhet të mbajë maskën mbrojtëse duke mbuluar hundën dhe gojën.
- 5- Personeli i punësuar/Administratori/Personi Fizik Tregtar duhet të përdorë dorezat mbrojtëse sipas këshillave.
- 6- Në hyrje subjekti duhet të ofrojë produktin higjenzues të duarve për klientët dhe të kujdeset për rimbushjen e tyre. Përqindja e substancës aktive duhet të jetë minimalisht 60%.
- 7- Klienti dezinfekton duart në hyrje dhe dalje nga subjekti. Klienti mban dorezat dhe maskën mbrojtëse sipas këshillave.
- 8- Duhet të garantohet dhe respektohet në çdo moment distanca prej 2 m midis klientit dhe personelit të punësuar.
- 9- Punonjësi i arkës lan duart dhe i dezinfekton ato paraveshjes dhe pas zhveshjes se dorezave.
- 10- Subjekti shërben vetëm një klienti në ambient, ndërkohë që të tjerët presin jashtë në rradhë me distancë 2 metra nga njëri-tjetri. Në ambientet më hapësirë mbi 30 metra katrorë mund të lejohet proporcionalisht një klient tepër për çdo 10 metra katrorë shtesë ambienti duke orientuar klientët në ruajtjen e distancës.
- 11- Subjekti duhet të afishojë në një vend të dukshëm në fasadë mundësinë e blerjeve online, mundësinë e rezervimit të takimit online apo me telefon.

- 12-Subjekti duhet të vendosë xham mbrojtës (ose plexiglass) klient shitës dhe shirit distance në banakun e arkës.
- 13-Në asnjë rast nuk lejohet kontakti fizik shitës-klient.
- 14-Subjekti duhet të kryejë dezinfektim të ambientit dhe larje para hapjes dhe pas mbylljes, sidomos të tavolinave, banaqeve, telefonave dhe çdo hapësire ku ka patur kontakt prekje.
- 15-Subjekti duhet të sigurojë ajrim sipas mundësisë minimalisht 3 herë në ditë. Ky detyrim për subjektet si parfumeri apo gjatë të cilave prodhohen gazra duhet të kryhet 6 herë në ditë.
- 16-Subjekti duhet të afishojë listën e simptomave të COVID-19 sipas checklistës së miratuar.
- 17-Për çdo rast Administratori/Personi Fizik Tregtar lajmëron menjëherë strukturat përkatëse veçanërisht Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe Inspektoriatin Shëndetësor Shtetëror.
- 18-Subjekti duhet të afishojë detyrimin për vetëvlerësim të simptomave nga klientët dhe personeli i punësuar/administratori/personi fizik tregtar sipas formatit të miratuar ku përmendet përgjegjësia administrative apo penale për personin që nuk merr masat sipas detyrimeve ligjore dhe numri jeshil për denoncim.